

08 Diaspora rrit dërgesat
financiare përmes bankave

13 Rreth 1.5 miliardë euro
investime të huaja në banka
dhe në patundshmëri

IBANK

Shkurt 2019 | Nr. 19 - Gratis

**Jupa: Këtë vit
presim investime
të mëdha**

FAQE 10

BANKIMI MILIARDËSH ME DIASPORËN

Transaksionet hyrëse dhe dalëse që realizojnë bankat në Kosovë me shtetet e ndryshme të botës, kryesisht me ato ku është e përqendruar diaspora kosovare, tejkalojnë vlerën prej 7 miliardë euro në vit. Bankimi me diasporën, sipas statistikave të Bankës Qendrore të Kosovës, po zhvillohet nga viti në vit, duke u realizuar kështu rreth 600 mijë transaksione bankare përgjatë vitit **FAQE 03**

**Avancimi i shërbimeve
bankare po e lufton
evazionin fiskal** **FAQE 16**

PROF. DR. IBISH MAZREKU



Sektori bankar nxit rritjen ekonomike dhe punësimin në Kosovë

Bankat komerciale të Kosovës janë duke vënë në dispozicion tërë kapacitetet e tyre për të rritur financimin e sektorit privat dhe ekonomive familjare, në mënyrë që Kosova të ketë rritje më të madhe ekonomike dhe të nxitet punësimi në vend.

Sipas një komunikate për media nga Shoqata e Bankave të Kosovës, gjatë vitit 2018, sektori bankar në Kosovë ka aprovuar 1.367.1 milionë euro kredi, nga të cilat 816.4 milionë euro ishin për sektorin privat, ndërsa 550.7 milionë euro ishin për ekonomitë familjare. “Bankat e vendit nga gjithsej kreditë e lëshuara, 59.7% të kësaj shume ua kanë dhënë bizneseve, duke vënë kapitalin në dispozicion të zgjerimit të kapaciteteve të tyre dhe duke e nxitur punësimin. Kreditimi i bizneseve bëhet sipas kërkesës së tregut e cila vjen si rrjedhojë e strukturës ekonomike të vendit. Kjo reflektohet edhe në kreditimin e sektorëve të ndryshëm ku sektori i tregtisë është më i kredituar se sektorët tjerë me një përqindje prej 48.8% të gjithsej kredive për sektorin privat”, thuhet mes tjerash në Komunikatën e Shoqatës së Bankave të Kosovës. Vlen të theksohet që sektori i ndërtimitarisë ka po ashtu një peshë më të madhe në këtë aspekt, me një pjesëmarrje prej 9%.

Në anën tjetër, sektorë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit, siç janë sektori i bujqësisë dhe prodhimitarisë, kanë shënuar rritje të konsiderueshme në vlerë të përgjithshme rreth 67.6 milionë euro për bujqësinë dhe 218.1 milionë euro për sektorin prodhues. Pjesëmarrja e tyre në gjithsej kreditë mbetet relativisht e ulët dhe e pandryshuar ndër vite. “Në këtë drejtim, bankat mbesin t’i gatshme të financojnë edhe këta sektorë por kërkohet që të ketë reforma thelbësore në këta sektorë, me mbështetjen e institucioneve shtetërore dhe organizatave zhvillimore ndërkombëtare, për t’i bërë këta sektorë më konkurrentë dhe për ta rritur

816.4 milionë €

euro kredi kanë aprovuar gjatë vitit të kaluar bankat komerciale për sektorin privat në Kosovë.

550.7 milionë €

kredi kanë aprovuar gjatë vitit të kaluar bankat komerciale për ekonomitë familjare.

218.1 milionë €

kredi kanë aprovuar bankat komerciale gjatë vitit 2018 për sektorin prodhues.

67.6 milionë €

kredi kanë aprovuar bankat komerciale gjatë vitit 2018 për sektorin e bujqësisë.

5.99%

kanë rënë normat e interesit në kredi gjatë vitit të kaluar në Kosovë.

2.7%

ka rënë niveli i kredive joperformuese në Kosovë.

kërkesën fizibile për kredi”.

Sektori bankar në Kosovë mbetet një prej sektorëve më transparent, ku të gjitha pasqyrat financiare, çmimoret për shërbime, dhe detaje tjera publikohen në baza të rregullta konform kërkesave ligjore dhe rregullativës në fuqi. Gjithashtu, ndikimi i sektorit bankar në financimin e bizneseve dhe të kërkesave të ekonomive familjare është mjaft substancial, duke bërë që ekonomia e vendit të vazhdojë një ritëm të mirë të rritjes përkundër shumë sfidave që ka kaluar dhe vazhdon të ketë. Normat mesatare të interesit për kredi në fund të vitit 2018 kanë shënuar 5.99%, përderisa edhe pjesëmarrja e kredive joperformuese mbetet e ulët në vetëm 2.7%. Ky është një përmirësim substancial

në norma të interesit kur kemi parasysh që sektori bankar ballafaqohet akoma me një numër pengesash në këtë treg. Disa nga pengesat më të mëdha që mbesin sfidë për zhvillim të mëtejshëm të këtij sektori janë efikasiteti i gjyqësorit në trajtimin e rasteve për zbatimin e kontratave, siguria fizike e stafit dhe pronës bankare, informaliteti i lartë në ekonomi, përdorimi i lartë i parasë së gatshme në transaksione me vlerë të vogël, dhe legjislacioni shpeshherë i papërshtatur dhe joproportional për parametrat e sektorit financiar të Kosovës. Në këtë drejtim, edhe në vitin 2019, sektori bankar synon që të rrisë qasjen në financa dhe të rrisë cilësinë e shërbimeve në shërbim të bizneseve dhe ekonomive familjare në vend.



Bankimi miliardësh me diasporën

Transaksionet hyrëse dhe dalëse që realizojnë bankat në Kosovë me shtetet e ndryshme të botës, kryesisht me ato ku është e përqendruar diaspora kosovare, tejkalojnë vlerën prej 7 miliardë euro në vit. Bankimi me diasporën, sipas statistikave të Bankës Qendrore të Kosovës, po zhvillohet nga viti në vit, duke u realizuar kështu rreth 600 mijë transaksione bankare përgjatë vitit

Mbi 7.1 miliardë euro ka arritur shuma e përgjithshme financiare e transfereve bankare hyrëse dhe dalëse gjatë dhjetë muajve (janar-tetor) të vitit të kaluar me shtetet e ndryshme të botës, ku kryesisht është e përqendruar diaspora kosovare. Bankimi me diasporën, sipas Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, është duke u zhvilluar vazhdimisht, përderisa ndër komponentët kryesorë në këtë drejtim janë remitencat, të cilat përgjatë pesë viteve të fundit kanë pasur një mesatare të rritjes vjetore

prej 8 për qind.

Zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Sokol Havolli, ka thënë se vetëm gjatë periudhës kohore janar-tetor të vitit të kaluar mbi 7.1 miliardë euro ka arritur shuma e përgjithshme e transfereve hyrëse dhe dalëse në bankat komerciale, ku vlera më e madhe e këtyre transfereve hyrëse ka qenë nga Anglia me 350 milionë euro, ose 12.8 % e transfereve të përgjithshme hyrëse ndërkombëtare përgjatë periudhës janar-tetor 2018.

TRANSFERET DALËSE 2017

Shteti	në numër	(në vlerë euro)	%në numër	% në vlerë
DE	37,408	511,507,079€	13.2%	10.5%
CH	36,672	124,902,600€	13.0%	2.6%
US	10,186	74,052,235€	3.6%	1.5%
GB	6,637	381,560,596€	2.3%	7.8%
AT	7,840	440,342,336€	2.8%	9.0%
Të tjerat	183,861	3,335,556,992€	65.1%	68.5%
Gjithsejtë	284,604	4,867,921,838€	100%	100%

TRANSFERET DALESE (TETOR - 2018)

Shteti	në numër	(në vlerë euro)	%në numër	% në vlerë
DE	32,145	506,173,177€	12.3%	11.6%
CH	34,514	96,772,081€	13.3%	2.2%
US	12,117	62,708,801€	4.7%	1.4%
GB	6,280	324,703,254€	2.4%	7.5%
AT	6,976	737,658,677€	2.7%	16.9%
Të tjerat	168,445	2,624,226,906€	64.7%	60.3%
Gjithsej	260,477	4,352,237,896€	100%	100%

Shteti	në numër	(në vlerë euro)
DE	-14.1%	-1%
CH	-5.9%	-22.5%
US	19%	-15.3%
GB	-5.4%	-14.9%
AT	-11%	-67.5%

Të tjerat
-8.4%

Gjithsej
-10.6%

TRANSFERET HYRESE 2017

Shteti	në numër	(në vlerë euro)	%në numër	% në vlerë
DE	41,089	329,436,394€	13.2%	11.5%
CH	71,775	222,174,835€	23.1%	7.8%
US	21,684	106,447,379€	7.0%	3.7%
GB	8,056	294,989,617€	2.6%	10.3%
AT	9,392	177,242,955€	3.0%	6.2%
Të tjerat	157,371	1,725,914,773€	51.0%	60.4%
Gjithsej	310,367	2,885,205,952€	100%	100%


TRANSFERET HYRESE (TETOR - 2018)

Shteti	në numër	(në vlerë euro)	%në numër	% në vlerë
DE	35,976	288,320,801€	12.5%	10.6%
CH	67,443	197,126,193€	23.4%	7.2%
US	23,670	109,860,730€	8.2%	4.0%
GB	7,574	350,033,199€	2.6%	12.8%
AT	9,189	255,552,867€	3.2%	9.4%
Të tjerat	143,940	1,523,811,209€	50.0%	55.9%
Gjithsej	287,792	2,724,704,999€	100%	100%

Shteti	në numër	(në vlerë euro)
DE	-12.4%	-12.4%
CH	-6.0%	-11.2%
US	9.1%	3.2%
GB	-5.9%	18.6%
AT	-2.1%	44.1%


Të tjerat
-9.11%

Gjithsej
-11.7%



350.000.000€ ose 12.8 %

e transfereve të përgjithshme hyrëse ndërkombëtare ka qenë shuma e përgjithshme nga Anglia përgjatë periudhës janar-tetor 2018.



288.300.000€ ose 10.6 %

e transfereve të përgjithshme hyrëse ndërkombëtare, ka qenë shuma e përgjithshme nga Gjermania përgjatë periudhës janar-tetor 2018.

Pas Anglisë, sipas tij, vlera më e madhe e transfereve hyrëse ndërkombëtare vjen nga Gjermania me gjithsej 288.3 milionë euro për periudhën e njëjtë kohore, apo 10.6% e gjithsej transfereve. 'Marrë në përgjithësi si grupvende, transferet ndërkombëtare hyrëse të Zvicrës, Gjermanisë, SHBA-ve, Anglisë, si dhe Austrisë përbëjnë vlerën prej 1.2 miliardë euro apo 44.1% e gjithsej transfereve ndërkombëtare hyrëse. Kur kësaj ia shtojmë faktin që pjesa kryesore e këtyre transferëve janë remitanca, i bie që në çdo 1 euro remitancë që dërgohet përmes bankave, 44 euro cent dërgohen vetëm nga këto pesë shtete', ka bërë të ditur Havolli.

GJATË VITIT 2017 MË SHUMË TRANSFERE HYRËSE DHE DALËSE ME GJERMANINË

Gjatë vitit 2017, transferet e përgjithshme hyrëse kishin arritur në rreth 2.86 miliardë euro, ndërsa shuma e përgjithshme e transfereve dalëse ka qenë 4.87 miliardë euro.

Transferet hyrëse gjatë vitit 2017 sipas shteteve kanë qenë si në vijim: Me Gjermaninë rreth 330 milionë euro, apo shprehur në përqindje rreth 11.5%, me Zvicër rreth 222 milionë euro apo 7.8%, me SHBA-të rreth 106 milionë euro apo 3.7%, me Anglinë rreth 294 milionë euro apo 10.3%, me Austrinë rreth 177 milionë euro apo 6.2% dhe pjesa tjetër prej rreth 1.7 miliardë euro apo 60.4% janë transfere hyrëse me

Zvicra, Gjermania, Anglia, Austria, SHBA-të janë shtetet që dominojnë në dërgimin e remitencave.

shtetet tjera. Ndërsa transferet dalëse gjatë vitit 2017 sipas shteteve kanë qenë si në vijim: Me Gjermaninë rreth 511 milionë euro, apo shprehur në përqindje rreth 10.5%, me Zvicër rreth 125 milionë euro apo 2.6%, me SHBA-të rreth 74 milionë euro apo 1.5%, me Anglinë rreth 381 milionë euro apo 7.8%, me Austrinë rreth 440 milionë euro apo 9.0% dhe pjesa tjetër prej rreth 3.3 miliardë euro apo 68.5% janë transfere dalëse me shtetet tjera.

RRETH 600 MIJË TRANSAKSIONE BANKARE NË VIT

Sa i përket numrit të përgjithshëm të transaksioneve që janë realizuar përmes sektorit bankar në vitin 2017, sipas zëvendësguvernatorit ky numër ka arritur në rreth 593 mijë transaksione. Ndërsa gjatë periudhës janar-tetor 2018, ky numër i transaksioneve kishte arritur në 548.269. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, shuma e transaksioneve të realizuara me SHBA-të në vitin 2017 ishte 180.5 milionë euro, apo shprehur në numër ishin 31.870 transaksione, ndërsa pjesa tjetër e shumës dhe numrit të transaksioneve ishte realizuar kryesisht me shtetet e BE-së. 'Trend i njëjtë ishte edhe deri në muajin tetor 2018, shuma e transaksioneve të realizuar me SHBA-të ishte 172.5 milionë euro apo shprehur në numër ishin 35.787 transaksione, pjesa tjetër e shumës dhe numrit të transaksioneve ishte e realizuar kryesisht me shtetet e BE-së', thotë Havolli.

7.100.000.000€

është shuma e përgjithshme e transfereve hyrëse dhe dalëse e realizuar nga sektori bankar i Kosovës përgjatë periudhës janar- tetor 2018.

520.300.000€

euro ka qenë shuma e përgjithshme e remitencave të dërguara në Kosovë gjatë periudhës janar – shtator 2018.

548.269

është numri i përgjithshëm i transaksioneve ndërkombëtare të realizuara gjatë periudhës janar-tetor 2018.



8%

kanë shënuar rritje mesatare vjetore remitencat përgjatë pesë viteve të fundit.

FORMALIZIMI I DËRGESAVE NGA DIASPORA

Zëvendësguvernatori Havolli thotë se dërgimi i parave nga jashtë në Kosovë paraqet një faktor të rëndësishëm në formalizimin e proceseve me anë të parave, ngase, sipas tij, evidentohet gjithçka lidhur me transferin e parave. “Gjithashtu, edhe bankat e kanë zhvilluar infrastrukturën e vet, duke zhvilluar platforma të avancuara të komunikimit dhe lehtësimit të shërbimeve me klientët. Marrë në përgjithësi, si pasojë e përmirësimit të kushteve lidhur me transferet ndërkombëtare, çështjes së sigurisë lidhur me transportimin fizik të parasë, si dhe arsye të tjera, vlera e parave që transferohen për remitanca dhe për qëllime të tjera është duke u rritur vazhdimisht”, shprehet ai.

LUFTIMI I EKONOMISË INFORMALE NËPËRMJET SEKTORIT BANKAR

Edhe ministri i Financave, Bedri Hamza, pranon se sistemi bankar është luftuesi kryesor i ekonomisë jo formale, krimin ekonomik, por edhe korrupsionit. Sipas tij, rritja e vazhdueshme e transaksioneve bankare përmes bankave është barometër i mirë. “Si çdo vend i botës edhe ne synojmë që në masë të madhe t’i eliminojmë parat “cash” dhe në këtë drejtim ia kemi arritur, për këtë bankat kanë një meritë shumë të madhe”, ka thënë ministri Hamza.

Ndërsa Muhamet Sadiku, njohës i mirë i rrethave ekonomike, thotë se bankat komerciale që operojnë në vendin tonë kanë luajtur, por edhe po luajnë një rol shumë të rëndësishëm në luftimin e ekonomisë jo formale. Profesor Sadiku thotë se në të kaluarën pjesa dërmuese e dërgesave nga diaspora kanë ardhur përmes rrugëve alternative, deri tash, sipas tij, pjesa dërmuese e tyre në vendin tonë vijnë përmes bankave që operojnë në Kosovë. “Në këtë drejtim bankat kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm, pasi që përmes sistemit bankat kemi një pasqyrë shumë të saktë të mjeteve që vijnë në vendin tonë”, ka thënë Sadiku. Sipas tij, deri së voni mjetet që kanë ardhur nga diaspora kryesisht kanë përfunduar në konsum, por, siç thotë ai, viteve të fundit bashkatdhetarët tanë që jetojnë në shtete të ndryshme të botës kanë marrë pjesë në procesin e privatizimit, por edhe investime tjera të fuqishme. “Të gjitha të dhënat, si për pjesëmarrje në privatizim, ashtu edhe në investime merren përmes sistemit bankar. Kështu që transaksionet përmes bankave eliminojnë krejtësisht ekonominë e zezë dhe për këtë sistemi bankat po jep një kontribut shumë të madh”, ka thënë Muhamet Sadiku. Po ashtu, sipas profesor Sadikut, dërgesat përmes rrugëve bankare i ndihmojnë edhe Institucionet e vendit në krijimin sa më të saktë të politikave për zhvillim. “Qytetaret kosovarë që jetojnë në shtete të ndryshme të botës tash e tutje është mirë që të orientohen në investime, pasi që përmes rritjes së investimeve, hapen vende të reja të punës, por

edhe ndikojnë direkt në zhvillimin ekonomik të vendit tonë”, ka thënë profesor Sadiku.

TË SHFRYTËZOHET MË SHUMË POTENCIALI FINANCIAR I DIASPORËS

Berat Rukiqi, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, thotë se përfundimisht sistemi bankar ka rëndësinë e veçante në transferimin e mjeteve në kanale formale, por sipas tij, duhet të krijohen edhe instrumente të veçanta bankare që mund t’i nxisin bashkëfinancimet në projekte inventive por edhe patundshmëri. Më tutje Rukiqi thotë se diaspora e ka rolin kyç në rritjen ekonomike të vendit, duke qenë një nder financuesit kryesorë të konsumit. Por, sipas tij, ajo që po mungon është absorbimi i potencialit të diasporës për investime që krijojnë vende pune dhe rritje të eksportit. “Nuk është vetëm aspekti financiar që duhet të absorbohet. Me rëndësi është edhe “know-how” që ka diaspora si dhe shfrytëzimi i rritjes që kanë diaspora si një mundësi e mire për rritje eksporti dhe promovim investimesh. Definitivisht sistemi bankar ka rëndësinë e veçante në transferimin e mjeteve përmes kanaleve formale, por duhet të krijohen edhe instrumente bankare të veçanta që mund t’i nxisin bashkëfinancimet në projekte, në investime por edhe patundshmëri”, ka thënë ai. Sipas kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës Qeveria duhet të krijojë pako të veçanta të stimujve fiskal që mund t’i rrisin investimet nga diaspora në projekte të rëndësishme zhvillimore.

Diaspora rrit dërgesat financiare përmes bankave

Bazuar në statistikat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), vitin e kaluar ka pasur rritje të dërgesave financiare nga diaspora kosovare përmes sistemit bankar. Përgjatë 13 viteve, vetëm nëpërmjet bankave, diaspora kosovare ka dërguar rreth 1.6 miliardë euro

Rreth 1.6 miliardë euro është shuma e përgjithshme e remiten-cave të dërguara nga diaspora vetëm nëpërmjet sistemit bankar të Kosovës përgjatë periudhës trembëdhjetë vjeçare, përkatësisht 2006-2018. Kjo bëhet e ditur në statistikat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), ku vërehet rritje e dërgesave financiare nëpërmjet kanaleve bankare gjatë viteve të fundit, derisa në anën tjetër vërehet rënie e mjeteve të dërguara përmes Agjencive për transefere të parave, por edhe përmes rrugëve tjera.

Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se nga diaspora, përmes rrugëve bankare, gjatë 11 muajve të parë të vitit që lamë pas kanë hyrë 112.8 milionë euro. Gjatë vitit 2017, po nga diaspora në Kosovë përmes transaksioneve bankare kanë ardhur 120.4 milionë euro, gjatë vitit 2016 kanë ardhur 116.3 milionë euro, gjatë vitit 2015 bashkatdhetarët dërguan përmes bankave 121.1 milionë euro, derisa gjatë vitit 2014 shuma totale e dërgesave përmes bankave ishte 115.2 milionë euro. “Gjatë vitit 2013, në formë të dërgesave përmes bankave kanë ardhur 115.4 milionë euro, gjatë vitit 2012 kanë ardhur 92.6 milionë euro, gjatë vitit 2011 kanë ardhur 93.9 milionë euro, gjatë vitit 2010 kanë ardhur 141.3 mil-

ionë euro, në vitin 2009 në kanë ardhur 148.8 milionë euro, në vitin 2008 kanë ardhur 126.3 milionë euro, gjatë vitit 2007 kanë ardhur 156.5 milionë euro, si dhe gjatë vitit 2007 kanë ardhur 156.5 milionë euro”, thuhet në raportet zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës.

Njohës të rrethanave ekonomike në vend, por edhe drejtues të Institucioneve të rëndësishme, thonë se diaspora në vazhdimësi ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit ekonomik në vend. Por, sipas tyre, ka ardhur koha që diaspora të ndërrojë qasje.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, thotë se dërgesat nga diaspora kanë qenë shumë të rëndësishme për shtetin e Kosovës.

Sipas tij, ato mjete kryesisht kanë përfunduar dhe po përfundojnë në konsum. “Nga diaspora ka shumë dërgesa dhe ato është shumë e vështirë të grumbullohen dhe me to duhet të bëhen investime kapitale, pasi që janë në vlera shumë të vogla. Por, në diasporë ka shumë biznesmenë të fuqishëm që kanë krijuar kapital në shtetet ku punojnë dhe veprojnë, por kanë edhe përvojë në menaxhim. Në si qeveri duhet t’u krijojmë më shumë mundësi njerëzve të tillë”, ka thënë ministri Financave Bedri Hamza.

**4.7
MILIONË
EURO**

**më shumë
sesa në
periudhën
e njëjtë të
vitit para-
prak është
shuma
e dërgesave
nga diaspora
përmes
bankave
komerciale
që op-
erojnë në
Kosovë.**


Remitencat e dërguara përmes bankave

(Të dhënat janë në milion euro)

2018 :1-11	112.8
2017	120.4
2016	116.3
2015	121.1
2014	115.2
2013	115.4
2012	92.6
2011	93.9
2010	141.3
2009	148.8
2008	126.3
2007	156.5
2006	135.1

**Total:
1.491.8
miliardë euro**

Janar – nëntor 2017



Total: 108.1

Janar – nëntor 2018



Total: 112.8

Jupa: Këtë vit presim investime të mëdha

Zëvendësministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bekim Jupa, është shprehur se gjatë këtij viti presin investime të mëdha në Kosovë, me ç'rast qeveria e vendit e ka krijuar infrastrukturën e nevojshme ligjore për investitorët e huaj

Gjatë vitit 2019 në Kosovë priten investime të mëdha nga jashtë. Këtë paralajmërim e jep zëvendësministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bekim Jupa. Ndër të tjera ai shtoi se ditë më parë me propozim të ministrit Endrit Shala, qeveria e vendit ka marrë vendim që t'i japë statusin e investitorit strategjik kompanisë gjermano-kosovare për prodhimin e energjisë së ripërtërishme "Sowi Kosovo", e cila brenda një periudhë pesë vjeçare ka planifikuar t'i investojë 170 milionë euro. Jupa gjatë kësaj interviste ka folur edhe për investimet e diasporës në Kosovë, duke thënë se ata nuk po dërgojnë vetëm para për konsum, por, siç shprehet ai, po investojnë edhe në biznese prodhuese.

Zëvendësministri Jupa pret që viti 2019 të jetë vit i revolucionit ekonomik, pasi që, siç thotë ai, tashmë në Kosovë kemi edhe investitorët e parë strategjik. I dyti i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, duke folur për suksesin e bizneseve të huaja në Kosovë ka përmendur edhe suksesin e investitorëve në sektorin bankar, ku nga 10 banka komerciale sa operojnë në vend, 8 prej tyre janë me kapital të huaj dhe të gjitha këto janë histori suksesi.

Z. Jupa, remitencat vjetore nga diaspora që vijnë nëpërmjet sektorit bankar të Kosovës arrijnë shumën në rreth 700 milionë euro në vit. Por, shumica e këtyre mjeteve shkojnë kryesisht në konsum dhe ka pak investime nga diaspora në sektorin prodhues. A keni ndonjë strategji qeveritare që diaspora kosovare të përfshihet më shumë në zhvillimin ekonomik të vendit?

Jupa: Si në të kaluarën, por edhe aktualisht, diaspora është duke e luajtur një rol shumë të rëndësishëm. Derisa më herët roli i tyre ka qenë më shumë një rol social, së fundmi diaspora është duke luajtur një rol të rëndësishëm edhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo për faktin se bashkatdhetarët tanë që jetojnë në shtete të ndryshme të botës tashmë nuk janë duke dërguar para vetëm për konsum, sa për të mbajtur një pjesë të familjes së tyre që e kanë në Kosovë. Qasja dhe kujdesi i tyre për vendin



Ne besojmë se viti 2019 do të jetë vit i revolucionit ekonomik, sepse tashmë i kemi edhe investitorët e parë strategjik, të cilët gjatë këtij viti planifikojnë që t'i realizojnë edhe projektet e tyre në vendin tonë.

ka ndryshuar, ata janë duke investuar në Kosovë, investime të cilat janë duke hapur edhe vende të reja të punës. Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, një rëndësi të veçantë është duke i kushtuar diasporës në përgjithësi. Ne në vazhdimësi i informojmë ata rreth mundësive që ofron Kosova për të investuar dhe për të bërë biznes, i informojmë rreth përfitimeve të shumta që mund t'i kenë krahasuar me investimet në vendet e rajonit, por edhe rreth infrastrukturës fiskale të vendit tonë, e cila është ndër më të favorshmet në rajon. Bazuar në të dhënat zyrtare që ne i kemi, gjatë vitit 2017, në vendin tonë në formë të remitancave kanë ardhur 759.2 milionë euro, derisa vetëm gjatë 11 muajve të parë të vitit

2018 kanë ardhur 731.5 milionë euro, e që pa dyshim se një pjesë e tyre janë investuar në biznese prodhuese. Po ashtu, gjatë 11 muajve të parë të vitit 2018, në formë të investimeve të huaja direkte, në Kosovë kanë ardhur 220 milionë euro.

Ne besojmë se viti 2019 do të jetë vit i revolucionit ekonomik, sepse tashmë i kemi edhe investitorët e parë strategjik, të cilët gjatë këtij viti planifikojnë që t'i realizojnë edhe projektet e tyre në vendin tonë. Falë ambientit të mirë për të bërë biznes në vendin tonë, tashmë kemi investitorë të shumtë të cilët janë të orientuar në sektorë të ndryshëm, si ai bankar, për të cilin theksuam edhe më lart se është një shembull i suksesit. Por, duhet ta përmendim se ka edhe shumë tregime të tjera të suksesshme.

PËRPARËSITË PËR INVESTIME NË KOSOVË

Në kuadër të Ministrisë së Tregtisë funksionon edhe Agjencia Kosovare për Promovim të Investimeve të Kosovës. Sa po punon kjo Agjenci me përfaqësuesit e bizneseve kosovare në diasporë për sjelljen e kapitalit të tyre në Kosovë?

Jupa: Agjencia Kosovare për Promovim të Investimeve të Kosovës ka bërë dhe po bën një punë të mrekullueshme në promovimin e resurseve dhe potencialit ekonomik të Kosovës në shtete të ndryshme të botës. Ashtu siç e thash edhe më lart, falë reformave të mira që janë bërë dhe masave të duhura, mjedisi i biznesit në Republikën e Kosovës është ndër më konkurruesit në rajon.

Ndërmarrja e këtyre hapave ka krijuar përparësi, sikurse janë sistemi i favorshëm i taksave, burimet e bollshme natyrore, regjistrimi i shpejtë dhe i lehtë i bizneseve, ligjet transparente mbi investimet e huaja, por edhe përparësi të tjera. Të gjitha këto e bëjnë Kosovën një mjedis atraktiv dhe të favorshëm për investuesit e huaj.

Për kompanitë që kërkojnë të investojnë në një vend me shpenzime të vogla e me qasje të lehtë në BE, në Evropën qendrore dhe në tregjet e Ballkanit, Kosova shihet si një mundësi atraktive. Po ashtu, në raportin tregues të Bankës Botërore për të bërit biznes, Kosova për çdo vit është duke treguar rezultate më të mira, duke konfirmuar progres të madh të vendit në zbatimin e reformave dhe përmirësimin e klimës së të bërit biznes.

A ka keni biseduar se cilat janë kërkesat e përfaqësuesve të diasporës për të investuar në Kosovë?

Jupa: Kontaktet tona me bashkatdhetarët tanë që jetojnë në shtete të ndryshme të botës janë të vazhdueshme. Institucionet e Kosovës në vazhdimësi janë në dispozicion të tyre për çfarëdo që ata kanë nevojë. Të gjithë investitorëve të mundshëm që kanë shprehur interesim për të investuar në vendin tonë ne ua kemi ofruar të gjitha informacionet e nevojshme, në mënyrë që ata ta kenë sa më të lehtë ta sjellin kapitalin e tyre financiar. Një pjesë e investitorëve të huaj që kanë shprehur interesim për investime në



Për kompanitë që kërkojnë të investojnë në një vend me shpenzime të vogla e me qasje të lehtë në BE, në Evropën qendrore dhe në tregjet e Ballkanit, Kosova shihet si një mundësi atraktive. Po ashtu, në raportin tregues të Bankës Botërore për të bërit biznes, Kosova për çdo vit është duke treguar rezultate më të mira, duke konfirmuar progres të madh të vendit në zbatimin e reformave dhe përmirësimin e klimës së të bërit biznes.

vendin tonë kanë kërkuar nga qeveria tokë (hapësirë) për investime. Për fat të keq, në disa raste e kemi pasur të pamundur t'ua plotësojmë këto kërkesa për shkak të infrastrukturës ligjore që është ende në fuqi. Por, MTI-ja, si për ta ashtu edhe për investitorët vendorë e ka pasur në dispozicion parkun e biznesin në Drenas, i cili plotëson të gjitha standardet e parapara. Po ashtu, gjatë vitit që e lamë pas, në lokacione të ndryshme në Kosovë, ne i kemi krijuar edhe disa parqe biznesi në mënyrë që investitorëve të mundshëm t'u krijojmë sa më shumë kushte dhe ambient të mirë për të bërë biznes

15 PANAIRE GJATË KËTJË VITI

Sa po arrijnë bizneset kosovare t'i shesin prodhimet e tyre në Evropë, përkatësisht në shtetet ku është e përqendruar diaspora kosovare?

Jupa: Prodhuesit kosovarë, falë cilësisë dhe standardeve të larta që ata po aplikojnë, çdo ditë e më shumë po e zgjerojnë tregun në rajon e në Evropë, por edhe më larg. Për t'i promovuar sa më shumë prodhimet e tyre, vetëm gjatë vitit që e lamë pas ne i kemi ndihmuar bizneset që të marrin pjesë në panairt: "Pro Ęein" në Gjermani, "PLMa" në Holandë, "SIAL" në

Francë, "PLMA" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, "ITB" në Gjermani, "Destination Nature" në Francë, "Fiera della Grazie" në Itali, "Turism Expo", në Japoninë, si dhe Panairi "MOW" në Gjermani. Pra, vetëm gjatë vitit 2018 janë realizuar 9 panairë ndërkombëtare. Numri i kompanive pjesëmarrëse në këto panairë është 41, numri i produkteve të ekspozuara në këto panairë ishte 282. Derisa për vitin 2019 janë të parapara 15 panairë ndërkombëtare, ku deri me tani janë mbajtur 2 prej tyre, në të cilat kanë marrë pjesë 10 kompani nga Kosova, i kemi edhe 13 panairë të tjera të cilat do t'i organizojmë gjatë këtij viti.

Gjatë pjesëmarrjes nëpër panairë prodhuesit vendorë kanë arritur të lidhin kontrata të mëdha. Ky është një tregues i miri dhe dëshmi për rritje të eksporteve të Kosovës. Bazuar në statistikat që ne i posedojmë, shihet se eksportet e Kosovës në drejtim të vendeve të BE-së në muajin dhjetor të vitit 2018 arritën në vlerën 7.3 milionë euro, ose rreth 25.0% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 7.1%. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin Gjermania me 6.7%,

Holanda me 3.4%, Italia me 2.8%, Sllovenia me 2.3% etj.

Në muajin dhjetor 2018, eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 13.3 milionë euro, ose 45.3% të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 11.8%. Partnerët kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s janë: Shqipëria me 23.0%, Maqedonia me 10.8%, Serbia me 5.6%, dhe Mali i Zi me 4.6%.

Ndërkaq, eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 8.7 milionë euro, ose 29.7%. Si partnerë më të rëndësishëm, për eksport nga këto vende vlen të përmenden: India 19.0%, dhe Zvicra me 5.7%

A pritët të ndodhë ndonjë investim i madh në Kosovë nga përfaqësuesit e diasporës vendore?

Jupa: Gjatë këtij viti ne presim që në vendin tonë të kemi investime shumë të mëdha dhe për këtë tashmë Qeveria e Kosovës ka krijuar infrastrukturën e nevojshme. Me propozimin e ministrit të Tregtisë dhe Industrisë z. Endrit Shala, para pak ditësh, Qeveria e Kosovës morri vendim që t'i jap statusin e investitorit strategjik kompanisë gjermano-kosovare të energjisë së ripërtërishme "Sowi Kosovo L.L.C". Në bazë të planit që ka prezantuar kompania në fjalë, është planifikuar që brenda 5 viteve në vendin tonë të investohen rreth 170 milionë euro.

Më saktësisht, është paraparë që investimi të behët në Selacë dhe Bajgorë të Mitrovicës.

Po ashtu, ne kemi edhe interesim të investitorëve tjerë të huaj për të investuar në sektorin e prodhimit të energjisë, në miniera, në administrimin e ujërave të zeza, në sektorin e shëndetësisë, por edhe sektorë të tjerë. Andaj, vendimi i Qeverisë për ta shpallur këtë investitorë strategjik është një lajm i madh dhe i mirë për vendin tonë.

10 banka, 3256 të punësuar

Numri i përgjithshëm i bankave komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës është dhjetë, tetë prej të cilave janë me kapital të huaj, përderisa dy janë me kapital vendor. Sipas një raporti të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) të muajit nëntor 2018, pronësia e huaj e bankave komerciale është 87 për qind, ndërsa 13 për

qind është vendore. "Numri i njëjësive të bankave komerciale në Kosovë është 225", thuhet mes të tjerash në raportin e BQK-së.

Sistemi bankar i Kosovës, sipas raportit të BQK-së, është një ndër punëdhënësit më të mëdhenj në sektorin privat, pasi që numri i përgjithshëm i të punësuarve arrin në 3256.

Në anën tjetër, vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit bankar kalon shifrën prej 4 miliardë euro. Shuma e përgjithshme e kredive të aprovuara në fund të vitit që e kemi lënë pas ka arritur në rreth 2.75 miliardë euro, ndërsa depozitat e përgjithshme kanë arritur në 3.25 miliardë euro.



2.750.000.000€

është vlera e përgjithshme e kredive të aprovuara nga bankat komerciale në Kosovë.

4.000.000.000€

është vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit bankar

3.250.000.000€

është vlera e përgjithshme e depozitave në banka komerciale

10

është numri i bankave komerciale në Kosovë



8

banka komerciale janë me pronësi të huaj



3256

është numri i përgjithshëm i të punësuarëve në sektorin bankar



Rreth 1.5 miliardë euro investime të huaja në banka dhe në patundshmëri

Nga 3.5 miliardë euro investime të huaja direkte në Kosovë përgjatë periudhës së fundit dymbëdhjetëvjeçare, rreth 1.5 miliardë euro kanë qenë investime në sektorin bankar dhe në atë të patundshmërive

Sektori bankar dhe ai i patundshmërive vazhdojnë të mbesin ndër sektorët më atraktiv për investitorët e huaj në Kosovë, derisa Gjermania edhe më tutje mbetet shteti me më së shumti investime direkte në vendin tonë. Bazuar në të dhënat zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se vetëm në këta dy sektorë (banka dhe patundshmëri) në Kosovë janë investuar më shumë se 1.5 miliardë euro, nga gjithsejtë 3.5 miliardë euro investime të huaja të evidentuara nga vitit 2007 e deri në fund të muajit nëntor të vitit që lamë pas.

PRUNË INVESTITORËT GJERMANË

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë këtyre 12 viteve të fundit investimet nga Gjermania zënë vendin e parë me 609 milionë euro, duke u ndjekur nga investitorët nga Zvicra

me 498 milionë euro. Investitorët nga Turqia zënë vendin e tretë për nga volumi i investimeve, për 12 vjet, nga ky shtet në vendin tonë në emër të investimeve të huaja direkte janë evidentuar 366 milionë euro, derisa në vendin e katërt për nga shuma e investimeve hyn Britania e Madhe me 343 milionë euro. Gjatë këtyre viteve një shumë të konsiderueshme të mjeteve prej 226 milionë euro e kanë investuar edhe biznesmenët nga Shqipëria, derisa ata nga Sllovenia kanë investuar 209 milionë euro. Biznesmenët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas të dhënave zyrtare të BQK-së, gjatë 12 viteve të fundit në vendin tonë investuan 174 milionë euro. Njohës të çështjeve ekonomike, por edhe përfaqësues të Institucioneve në vend, thonë se investimet e huaja kanë ndikuar drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit. Sipas tyre, një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka luajtur edhe sektori bankar, që pjesa dërmuese e tij

është me kapital të huaj.

SEKTORI BANKAR, STORIE SUKSE SIPËR INVESTITORËT

Haki Shatri, këshilltar i kryeministrit të Kosovës Ramush Haradinaj, thotë se Qeveria e vendit iu kushton një rëndësi të veçantë investimeve të huaja direkte në vendin tonë. Sipas tij, në vazhdimësi Institucionet janë munduar dhe po mundohen që të krijojnë sa më shumë kushte të mira për investitorët e huaj që një pjesë të kapitalit të tyre e kanë investuar në vendin tonë. Në këtë drejtim si storie suksesi, sipas tij, mund edhe të konsiderohet sektori bankar që është shumë i qëndrueshëm dhe joshës për investitorët e huaj. "Investitorët e huaj janë të fokusuar të investojnë më shumë në sektorin financiar dhe atë të patundshmërive pasi që janë më të konsoliduar dhe joshës", ka thënë ai

Investimet e huaja direkte në Kosovë

Shteti	2018 (1-11)	2017	2016	2015	2014	2013
Austri	6.6	20.3	9.9	33.5	30.3	10.7
Gjermani	57.3	55.9	25.7	45.3	29.4	21.7
Sllovenia	-0.3	1.2	-4.5	5.6	-9.4	7.0
Anglia	13.2	27.0	13.6	26.6	-39.5	10.7
Zvicra	62.9	50.6	61.8	72.9	38.2	41.7
Turqia	-15.4	29.5	42.7	55.4	20.0	88.6
Holanda	10.1	-14.1	-23.1	-36.4	-7.8	0.1
Shqipëria	19.1	2.4	28.6	40.1	20.4	19.3
Luksemb	2.2	2.1	0.6	0.1	1.2	2.3
Serbia	0.2	-1.4	0.6	0.8	2.4	5.7
SHBA	18.1	20.3	23.0	25.0	14.7	12.7
Franca	4.8	3.6	2.8	3.2	3.3	3.8
Bullgaria	2.1	0.5	0.4	1.6	14.5	5.6
Maqed.	2.6	-1.0	3.2	0.1	3.2	4.6
Bosnja	0.4	0.7	1.2	0.8	0.3	0.2
Kroacia	0.1	0.7	-1.7	0.1	1.1	1.3
Malta	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	3.1
Qipro	1.2	0.8	0.4	0.1	0.3	0.3
Sllovakia	0.5	0.1	0.8	0.1	0.1	0.2
Kanada	3.1	3.0	2.5	1.1	0.9	1.2
Çekia	1.5	0.7	0.2	1.3	0.4	0.2
Emiratet	-3.7	13.4	3.6	1.4	1.3	-0.8
Norvegjia	4.5	3.5	3.4	2.9	5.9	4.7
Kuvajti	-1.1	0.0	0.2	0.0	0.5	2.0
Spanja	0.2	2.5	0.2	-0.8	0.1	0.2
Egjipti	0.0	0.0	/	0.0	0.1	/
Italia	1.9	7.0	1.9	5.7	3.3	8.7
Greqia	-0.1	7.0	1.9	5.7	3.3	8.7
Të tjera	27.2	27.3	23.3	22.4	16.6	25.2

në periudhën 2007-2018

2012	2011	2010	2009	2008	2007	TOTAL
0.2	19.6	21.1	15.5	51.3	35.4	254,4
49.2	66.6	31.5	75.2	44.0	48.1	609.9
8.0	16.2	43.0	50.8	44.3	56.2	209.1
14.3	80.1	38.9	6.2	36.6	116.2	343.9
39.7	30.9	35.1	22.7	32.1	9.7	498.4
62.7	34.7	4.9	14.5	23.8	5.4	366.7
-26.7	4.7	17.2	23.1	25.9	41.2	14.0
16.8	11.2	20.3	23.3	21.4	3.4	226.7
1.3	0.5	0.4	8.3	6.0	13.1	38.2
0.5	0.4	0.4	0.6	5.5	0.0	14.6
8.5	14.3	12.6	11.6	4.8	8.8	174.8
6.9	0.2	3.8	6.0	3.5	8.6	50.4
8.1	3.4	0.0	/	2.8	14.2	53.3
-9.6	5.8	1.8	1.5	2.0	0.4	14.6
0.0	0.1	0.8	0.5	0.7	0.2	5.9
0.4	2.9	1.8	0.7	0.7	5.8	13.9
4.3	0.2	0.9	/	0.6	0.3	9.6
0.3	1.0	0.0	0.3	0.3	0.1	5.0
/	0.0	0.0	0.1	0.2	0.0	2.1
1.3	0.5	0.8	0.3	0.2	0.6	15.4
5.7	1.3	0.0	0.4	0.2	0.1	11.9
0.8	6.5	8.7	0.1	0.1	/	32.1
2.4	2.5	3.3	2.5	0.1	0.6	36.3
0.6	0.2	1.6	0.5	0.1	/	4.6
0.2	/	0.1	0.1	0.1	1.0	4.0
0.1	/	/	0.1	0.1	/	0.4
3.9	1.7	6.6	6.0	0.1	5.5	52.2
3.9	1.7	6.6	6.0	0.1	5.5	6.1
28.7	78.6	55.8	15.9	61.9	63.5	446.5

Avancimi i shërbimeve bankare po e lufton evazionin fiskal



PROF. DR. IBISH MAZREKU

Dihet se remitencat janë faktorë shumë i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik në Kosovë. Nëse e bëjmë një analizë të dërgesave të qytetarëve tanë nga paslufta e kënde, rezulton se nga ajo kohë, prej viti në vit, dërgimi i remitencave në Kosovë ka pasur rritje dyshifrore. Kjo rritje ka vazhduar deri në krizën e madhe financiare globale të vitit 2008. Edhe pas kësaj krize remitencat kanë pasur rritje prej viti në vit, mirëpo kjo rritje është njëshifrore, çka tregon se kriza financiare globale ka ndikuar në dërgimin e remitencave në Kosovë përmes rrugëve të ndryshme.

Nëse bëjmë analizë duke i ndarë në grupe emigrantët tanë, p.sh. sipas kohërave, si: emigrantët e viteve 1960-1970, emigrantët e viteve 1989-1997, emigrantët e viteve 1998-1999 dhe emigrantët e pasluftës, është lehtë e konstatueshme se ata kishin rrethana më të lehta të kursenin, sepse jetonin të vetëm, pa familje dhe tërë ato kursime i sillnin në vendlindje. Këto mjete kryesisht janë shfrytëzuar për mirëqenien e familjes, jo për ndonjë investim. Mirëpo, kjo gjë është zbehur me kohë për shkak të ndryshimit të mënyrës së jetesës së tyre. Shihet qartë se remitencat maturohen me kohë, si shkak i ndryshimit të mënyrës së jetesës dhe sasia e tyre është më e vogël.

Parashtrahet pyetja, cilat janë rrugët nëpër të cilat dërgohen këto remitencat, janë rrugë përmes sistemit financiar, përmes bankave komerciale, institucioneve të transferit të parave, apo dërgesa fizike përmes të afërmeve apo ndonjë rrugë tjetër jashtë sistemit financiar. Dërgimi i remitencave përmes sistemit financiar çfarëdo qoftë na mundëson që ta përcjellim trendin e dërgesave prej viti në vit, mirëpo gjithmonë ekziston një dilemë në lidhje me dërgesat reale të remitencave, sidomos atyre jashtë sistemit financiar. BQK apo edhe institucionet relevante në lidhje me këtë çështje përdorin metoda të cilat përafërsisht mund të na tregojnë se cilat janë dërgesat reale.

Në bazë të informatave aktuale shohim që në periudhën e pasluftës remitencat kryesisht janë dërguar fizikisht, kjo edhe për shkak të pagesës së sistemit financiar/bankar. Me fillimin e sistemit bankar në Kosovë, ky sistem filloi të përdoret por shumë minimalisht. Ky sistem gradualisht është zhvilluar duke aplikuar teknologjitë bashkëkohore. Me implementimin e swift kodit të Kosovës janë krijuar mundësi dhe kushte që sistemi financiar bankar dhe institucioneve

financiare të shfrytëzohet me shumë. Kohëve të fundit, nga emigrantët të ndryshëm është një prirje e dërgesave në shuma të vogla të cilat kryesisht përdoren për konsum familjar.

Sot kemi dilema se si të shfrytëzohen mjetet e diasporës në mënyrë më efektive, ka ide e propozime të ndryshme, bile kemi edhe një resor qeveritar për diasporën. Sot shumë proklamohet që duhet ta kemi një bankë të diasporës e cila do t'i përdorte fondet e veta për zhvillim ekonomik të vendit, sidomos ato projekte madhore që do të gjeneronin zhvillim ekonomik dhe krijim të vendeve të punës. Parashtrahet pyetja si do të ishte statusi juridik i kësaj banke, kush do të ishin pronarët, si do të menaxhohej, cilat do të ishin mënyrat e motivimit të diasporës për ta shfrytëzuar këtë bankë për depozitim të mjeteve individuale apo të korporatave etj. Deri tani nuk e kemi gjetur një model efikas se si do të duhej të shfrytëzohej diaspora më mirë. Ndoshta iniciativat pozitive do të duhej të vinin nga bizneset e diasporës të cilat janë të organizuara nëpër vende të ndryshme të Evropës dhe Amerikës

Si do të luanin rol bankat, gjegjësisht sistemi bankar në Kosovë në luftimin e informalitetit ekonomik të bizneseve? Dihet që rol kyç në luftimin e informalitetit ekonomik dhe evazionit fiskal luan shteti përmes institucioneve relavanet të ekonomisë, institucioneve publike dhe institucioneve të drejtësisë. Roli i sistemit bankar do të ishte më shumë në aspektin e infrastrukturës logjistike. Përdorimi i sistemit bankar do të mundësonte që të gjitha transaksionet e mundshme financiare të bëheshin përmes sistemit bankar dhe përmes këtij sistemi shteti do të mund të përcillte trendet ekonomike, pastaj do të inkasonte obligimet të cilat rrjedhin nga këto transaksioni d.m.th. vjelja e tatimeve sipas ligjeve në fuqi.

Informatizimi i bizneseve përmes përdorimit të teknologjisë dhe sistemeve për blerje dhe pagesa online, jo vetëm që do të evidentonte transaksionet financiare, por do të evitonte përdorimin e cash-it.

Bankat luajnë rol të rëndësishëm përmes vetëdijesimit të qytetarëve dhe bizneseve që ta përdorin sistemin bankar për kryerjen e aktiviteteve ekonomike. Vetëdijesimi i qytetarëve për përdorimin e kartelave bankare është detyrë e institucioneve financiare, rregullatorit dhe bankave komerciale. Rritja e përdorimit të kartelave do ta zvogëlonte evazionin fiskal.

(AUTORI ËSHTË
PROREKTOR
PËR
MARRËDHËNIE
ME JASHTË NË
UNIVERSITETIN
PUBLIK "HAXHI
ZEKA" NË PEJË)

